



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI TEKNIK

Nr. 187 Prot.

Tiranë, më datë 23.04.2026

VENDIM

Nr. 42, datë 23.04.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, si dhe në Vendimin e KKTKM-së, Nr. 75 datë 19.02.2020 “Për miratimin e llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore, sipas listës bashkëlidhur”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektit, në mbledhjen e datës 23.04.2026, Këshilli Teknik:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “*Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin shfrytëzimin administrimin, pronësinë, mirëmbajtjen e impiantit fotovoltaik me kapacitet 63.92 MWp, përfshirë linjën elektrike të lidhjes, gjurmën e saj, veprat ndihmëse dhe infrastrukturën shoqëruese të projektit i cili nuk është objekt koncesioni dhe përfiton masa mbështetëse*”, me vendndodhje në Njësinë Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, të zgjedhur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Aga Solar” sh.p.k. dhe “Notus Energy” sh.p.k., me zhvillues subjektet “**Aga Solar**” sh.p.k. dhe “**Notus Energy**” sh.p.k.;
2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për “*Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin shfrytëzimin administrimin, pronësinë, mirëmbajtjen e impiantit fotovoltaik me kapacitet 63.92 MWp, përfshirë linjën elektrike të lidhjes, gjurmën e saj, veprat ndihmëse dhe infrastrukturën shoqëruese të projektit i cili nuk është objekt koncesioni dhe përfiton masa mbështetëse*”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KT
Endri HAXHIU